



OSHP: 2024/0705

Vendim

1. **Aprovohet sie pjesërisht e bazuar** ankesa e OE “Arianit R. Bytyqi” B.I. kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirembajtje dhe avancim i sistemit temenaxhimit terasteve -SMR-DRPRIH-Ri tender” me numër të prokurimit 214-24-4177-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.
2. **Mbetet në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 18.07.2024.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Arianit R. Bytyqi

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 29.04.2024 Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirembajtje dhe avancim i sistemit temenaxhimit terasteve -SMR-DRPRIH-Ri tender” me numër të prokurimit 214-24-4177-2-2-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për shërbim, me vlerë të parashikuar 51,000.00€.

Me datë 18.07.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Rener Sh.P.K & PBC Sh.P.K”.

Me datë 23.07.2024, OE ankues “Arianit R. Bytyqi” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 26.07.2024.

Me datë 02.08.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0705.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues:

Pretendimi 1 : *“GOE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me stafin profesional teknik, ku në DT është kërkuar një menaxher i projektit-Inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, diploma e dorëzuar për znj. A.M.M. nuk i plotëson kriterin sipas dosjes.*

Pretendimi 2 : *“ Kërkesa e DT-së dhe njoftimit për kontratë tek fleta e të dhënave të tenderit, ku është kërkuar menaxheri i projektit të jetë inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, për zv. menaxheren e projektit znj. D.A. sipas listës së dorëzuar, diploma nuk i plotëson kriterin e dosjes.”.*

Pretendimi 3: *“Është kërkuar sipas dosjes që menaxheri i projektit të jetë inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, për zv. menaxherin e projektit, sipas listës z. M.B. është dorëzuar diploma e cila nuk i plotëson kriterin e dosjes dhe nuk ka përvojë 5 vjeçare pas diplomimit”.*

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: *“ Deklarimi i tenderuesit ankues se vlerësimi nga AK është jo i drejtë, është shkelur neni 1 i LPP-së është i pabazuar sepse AK përkundrazi e ka shpallur fitues tenderuesin i cili ka dorëzuar Tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, me këtë c ka respektuar qëllimin që rrjedh nga ky Neni 1 Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni7) Pretendimi i tenderuesit ankues NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.), Prishtinë, thotë se AK me rastin e vlerësimit të tenderëve, ka shkullur Neni 7 i LPP-së - Barazia Trajtim/ jo-Diskriminues, është i pabazuar, sepse me rastin e vlerësimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues Tenderin tuaj e ka vlerësuar me kujdes dhe ju ka njoftuar ne letër standarde për Tenderuesin e pasuksesshëm dhe nuk kemi të bëjë me kurrfarë diskriminimi. Me shpalljen fitues, tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të ulët, i cili i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara në Dosje Të Tenderit dhe në Njoftimin për kontratë, AK nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së tij, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të Nenit 7 të LPP-së. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59 i LPP-së) Autoriteti Kontraktues,*

konstaton se Pretendimi i tenderuesit ankues NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.), Prishtinë, se nuk është zbatuar si duhet Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve, nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues, pasi ka shqyrtuara me kujdes kërkesën për rishqyrtim, konstaton edhe një herë se nuk qëndrojnë pretendime e ankuesit, sepse AK gjatë vlerësimit të tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit iu ka përmbajtur dhe ka zbuluar nenin 59 par. 4 të LPP-së, citojmë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjalë është në përputhshmeri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Tenderi juaj, NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.), është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në njoftimin për kontratë dhe DT, me letër standarde jeni njoftuar se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk që i suksesshëm, ngase nuk që tenderi një çmimin më të ulët, në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe DT. Tenderi i tenderuesit të shpallur fitues (Grup i OE, RENER SH.P.K. & PBC SH.P.K.), është vlerësuar me kujdes dhe pretendimi i Juaj se MPB nuk e ka kryer ekzaminim të saktë sipas Dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë, lidhur një GOE të shpallur fitues me vendimin e datës 18.07.2024, pasi që ky GRO mik i plotësojnë kërkesat e FDT dhe NjK, nuk qëndron. Ky konstatim është i pa bazuar dhe nuk qëndron, sepse tenderuesi i propozuar për fitues, i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës edhe për kërkesën nr.1 Menaxher të projektit- (1 Zyrtar). Tenderues i shpallur fitues, për këtë kërkesë ka dorëzuar dëshmi diplomë fakulteti të Universiteti të Tiranës për inxhinieren (A.M.M), e cila ka diplomuar në vitin 2003 ka marrë titullin Informatikan dhe sipas hulumtimeve në Universitetin e Tiranës ky titull përfshinë shkencat kompjuterike dhe si e tille e plotëson kërkesën e AK për Menaxher të projektit - Inxhinier i Kompjuterikes, gjithashtu në diplomën e Dorëzuar nga për menagjer të projektit askund nuk figuron titullin Bachelor siç pretendon ankuesi, pasi që në këtë kohë nuk ka ekzistuar Programi i studimit "Bachelor" në Informatikë. Ndërsa sa i përket zëvendës Menaxhereve të prezantuar të cilët janë atakuar në ankese, ju njoftojmë se me dosjen e tenderit nuk kemi kërkuar zëvendës menaxher andaj edhe nuk kanë qenë objekt i vlerësimit të ofertës".

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.08.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 23.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim".

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Lidhur me pretendimin e parë - "Eksperti shqyrtues sqaron se si kërkesë e kapacitetit teknik dhe profesional sa i përket stafit të angazhuar ka qenë që operatorët të kenë një menaxher të projektit i cili ka diplomë universitare në inxhinieri kompjuterike me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë pune minimum prej 5 vitesh pas diplomimit. OE i rekomanduar ka dorëzuar listën e stafit sipas kërkesave, ku njëri prej tyre është emëruar menaxher i projektit ndërsa dy të tjerë janë emëruar si zëvendës menaxher të projektit. Menaxherja e projektit e emëruar ka dorëzuar dëshmitë, ndër to edhe diplomat e kërkuara. Nga dokumentet e dorëzuara shihet se për këtë menaxhere janë dorëzuar

dy diploma, bachelor dhe ajo master. Nga diploma bachelor shihet se titulli i marrë pas diplomimit është titulli “Informatikan” dhe dega Informatikë, ndërsa diploma master e menaxheres së projektit është në studimet ekonomike evropiane. Sipas ekspertit këto diploma nuk përkojnë me kërkesat e dosjes së tenderit ku është kërkuar që menaxheri të ketë titullin inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion në rastin e studimeve themelore ose të ketë diplomë master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike. Eksperti pasqyron që edhe pse titulli informatikan ka shumë ngjashmëri me programin shkenca kompjuterike megjithatë kjo diplomë do të mund të merrej se është relevante vetëm në rastin se do të ishte e nivelit master për t’u konsideruar në përputhje me kërkesat e dosjes, sepse siç e kemi sqaruar sa i përket studimeve themelore sipas kriterit të dosjes është kërkuar vetëm inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion dhe jo ndonjë drejtim tjetër. Andaj, sipas ekspertit ky kriter nuk është përmbushur nga operatori i rekomanduar dhe sipas kësaj që sqaruar vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i bazuar.”

Lidhur me pretendimin e dytë - *“Pas analizimit të dokumenteve të dorëzuara për zv.menaxheren e projektit D.A., eksperti sqaron se së pari kërkesë e dosjes ka qenë që të emërohet vetëm një menaxher i projektit sipas kërkesave dhe dëshmime të kërkuara, pra nuk është kërkuar që të përcaktohen dhe të emërohen edhe zv.menaxher të tjerë. Megjithatë, operatori i rekomanduar ka dorëzuar në listë dhe ofertë edhe dokumentet për zv.menaxheren. Eksperti sqaron se zv.menaxherja ka dorëzuar në ofertë diplomën bachelor me titullin bachelor në shkencat e aplikuara dhe arte dhe diplomën master i shkencave të kontabilitetit. Sipas ekspertit asnjëra nga këto dy diploma nuk përmbushë kriterin e dosjes, andaj edhe nëse do ishte caktuar personi në fjalë si menaxhere e projektit, përsëri e njëjta nuk do të përmbushte kërkesat e kërkuara.”*

Lidhur me pretendimin e tretë - *“Në ofertë janë dorëzuar dokumentet edhe për një person tjetër nga stafi i cili është emëruar si zv.menaxher i projektit. Për zv.menaxherin M.B. është dorëzuar një diplomë bachelor me titullin bachelor i shkencave kompjuterike dhe inxhinieri. Diploma e dorëzuar sipas ekspertit nuk përkon me kërkesat e dosjes, ku për nivelin themelor është kërkuar drejtimi telekomunikacion ndërsa për master është lejuar edhe shkencat kompjuterike, përveç kësaj nuk është i përmbushur as kushti i dytë që menaxheri i projektit duhet të ketë minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Përderisa stafi M.B. ka përfunduar studimet në vitin 2020 atëherë vlerësojmë që nuk është përmbushur as kushti i përvojës së punës. Në anën tjetër po ashtu sqarojmë se në dosje të tenderit nuk ka pasur kërkesë për zv. menaxher të projektit”.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizo i të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë nuk janë të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë ankimor, Paneli Shqyrtues ka analizuar me vëmendje pretendimin ankimor. Fillimisht duhet sqaruar se në dosjen e tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit të jetë inxhinier i kompjuterikës. Në anën tjetër tenderuesi i rekomanduar ka për menaxherin e projektit ka dorëzuar diplomën nga Universiteti i Tiranës – Dega Informatikë për inxhinieren A.M.M. e cila në vitin 2003 ka marrë titullin “informatikan” sipas sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Paneli Shqyrtues ka analizuar me kujdes edhe konstatimin e ekspertës shqyrtuese ku thuhet se titulli “informatikan” nuk bën pjesë në shkencë kompjuterike mirëpo do të mund të merrej parasysh vetëm në rast se do të ishte diplomë e nivelit master. Paneli Shqyrtues këtë konstatim e konsideron si të paqëndrueshëm pasi që konstatimi fillimisht është kundërtshënës. Dega e studimeve të informatikës në Universitetin e Tiranës ose bën pjesë në kuadër të shkencave kompjuterike ose nuk bën pjesë në këtë grup të shkencave. Në rast se bën pjesë, atëherë kjo duhet të vlej si për nivelin bachelor ashtu edhe për master. Pra nuk ka mundësi që një program i studimit të bën pjesë në kuadër të shkencave kompjuterike në nivelin master por të mos bëj pjesë në këtë grup në nivelin bachelor. Për më tepër, ekspertja nuk sqaron që sipas saj nëse informatika nuk qenka pjesë e shkencave kompjuterike, atëherë në cilin grup të shkencave bën pjesë. Njëkohësisht nuk argumenton as arsyet pse ky program nuk duhet të merret si ekuivalent me programin e inxhinierisë kompjuterike sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht arsyetimi i ekspertit shqyrtues është i pabazuar. Sa i përket pretendimit ankimor, Paneli Shqyrtues konsideron që programi i informatikës në Universitetin e Tiranës/Republikën e Shqipërisë duhet të merret si ekuivalent me programin e kompjuterikë në cilindo universitet të akredituar në Republikën e Kosovës. Nga ky kënd i vështrimit, tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur në tërësi këtë kërkesë të dosjes së tenderit ndërsa pretendimi ankimor i parashtresit

është i pabazuar. Paneli Shqyrtues nuk i ka faluar besimin ekspertës shqyrtuese për arsyet e elaboruara si më lartë.

Lidhur me pretendimin e dytë dhe të tretë ankimor, Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet ankimore janë të drejtuara kundër stafit që tenderuesi i rekomanduar i ka emëruar si zëvendës të menaxherit të projektit. Fillimisht duhet sqaruar se në dosjen e tenderit nuk ekziston asnjë kërkesë ku thuhet se tenderuesit duhet të emërojnë një ose më shumë zëvendës të menaxherit. Pra këto dokumente që janë prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar nuk janë kërkuar as me dosje të tenderit dhe as me sqarime shtesë nga autoriteti kontraktues. Si të tilla këto dokumente duhet të trajtohen si dokumente shtesë pa ndonjë ndikim në vlerësimin e ofertës së tenderuesit përkatës. Pavarësisht kësaj, me rastin e zbatimit të kontratës autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh procedurat dhe kushtet ligjore sipas të cilave dikush mund të caktohet si zëvendës menaxher i një projekti të caktuar. Kjo nënkupton që përderisa dokumentet në fjalë duhet të trajtohen si dokumente teprice, të njëjtat nuk mund të merren në konsideratë as me rastin e zbatimit të kontratës. Sa i përket konstatimeve të ekspertit shqyrtues, ku thuhet se personat e prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar si zëvendës të menaxherit nuk i përmbushin kushtet për menaxher të projektit, duhet cekur se ky konstatim është jorelevant përderisa me dosje të tenderit nuk është kërkuar zëvendës menaxher të projektit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues gjeti se pjesa e vetme e bazuar e ankesës ka të bëjë me faktin që personat e prezantuar si zëvendës menaxher nuk i plotësojnë kushtet për menaxher të projektit. Mirëpo përderisa nuk është kërkuar zëvendës menaxher me dosje të tenderit, këto pretendime dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues nuk janë relevante dhe nuk kanë fituar besimin e Panelit Shqyrtues. Pjesa tjetër e pretendimeve ankimore janë gjetur si të pabazuara në tërësi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet por vetëm si pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme i datës 18.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirembajtje dhe avancim i sistemit të menaxhimit të rasteve - SMR-DRPRIH- Ri tender” me numër të prokurimit 214-24-4177-2-2-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonësave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - Arianit R. Bytyqi**
- Arkivës së OSHP-së: